



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 68

Tiranë – E martë, 4 prill 2017

PËRMBAJTJA

| | | Faqe |
|---|--|------|
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 27.3.2017 | Me objekt: konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë..... | 3709 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 27.3.2017 | Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 666, datë 6.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 6, datë 9.1.2013, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2016-13, datë 14.1.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... | 3713 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 27.3.2017 | Me objekt: shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2015-2087, datë 2.7.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 49, datë 16.7.2012, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; nr. 24, datë 25.1.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 54, datë 3.10.2011, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; nr.17, datë 28.3.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë..... | 3718 |



VENDIM
Nr. 25, datë 27.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

| | | |
|-----------------|-----------|----------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i | Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.2.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 2 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Ilir Tasha

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Shëndetësisë, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë,

Përmbartuesi Privat Xhafer Sadiku

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, që kërkoj pranimin e kërkesës, pretendimet e subjekteve të interesuara, Ministrisë së Shëndetësisë, e cila kërkoj pranimin e kërkesës dhe Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, i cili kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Ilir Tasha është diplomuar mjek i përgjithshëm në vitin 1992, si dhe është specializuar mjek obstetër-gjinekolog në vitin 1998. Prej vitit 1998 deri në vitin 2005 ka punuar në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik (SUOGJ) “Mbretëresha Geraldinë”. Nga viti 2005 e në vazhdim ka punuar në SUOGJ-në “Koço

Gliozheni”. Në datën 4.4.2013 me urdhër të ministrit të Shëndetësisë kërkuari është emëruar në pozicionin shef i Klinikës së Patologjisë së Barrës.

2. Ministri i Shëndetësisë, me urdhrin nr. 282, datë 30.4.2013, ka urdhëruar organizimin e shërbimeve dhe kthimin sipas strukturës dhe pozicioneve para miratimit të VKM-së nr. 771, datë 7.11.2012, “Për miratimin e kriterëve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat [spitalore universitare](#)” të drejtuesve e tyre. Riorganizimi do të bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë”.

3. Kërkuari së bashku me 2 mjekë të tjerë, me pretendimin se urdhri i ministrit është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke paditur Ministrinë e Shëndetësisë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së urdhrin nr. 282, datë 30.4.2013 të ministrit të Shëndetësisë. Me vendimin e datës 7.6.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pezullimin e zbatimit të aktit administrativ.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9441, datë 23.9.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, konstatimin e pavlefshmërisë së urdhrin nr.282, datë 30.4.2013 të ministrit të Shëndetësisë dhe ligjërimin e vendimit të datës 7.6.2013 për pezullimin e zbatimit të urdhrin të ministrit. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 6.11.2013, pasi nuk është ankimuar.

5. Me vendimin nr. 9441/U, datë 23.9.2013 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin gjyqësor të formës së prerë.

II

6. **Kërkuari Ilir Tasha** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

7. **Subjekti i interesuar, Ministria e Shëndetësisë**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

7.1 Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionin e arsimit të lartë në Republikën e



Shqipërisë”, ministria po ndërmerr hapat e nevojshëm për nxjerrjen e akteve nënligjore që lidhen me mënyrën e organizimit të strukturave shëndetësore universitare, si dhe mënyrën e përzgjedhjes së drejtuesve të shërbimeve spitalore.

7.2 Ministria e Shëndetësisë, me shkresën nr. 640 prot., datë 29.1.2014, i ka kërkuar drejtorit të spitalit “Koço Gëlozheni” marrjen e masave për zbatimin e vendimit, duke vlerësuar se drejtori i këtij spitali i ka pasur të gjitha mundësitë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

7.3 Çështja paraqitet komplekse nga pikëpamja faktike dhe ligjore, çka justifikon dhe vonesat në ekzekutim. Ministria vlerëson se përmbartuesi gjyqësor nuk ka ushtruar të gjitha kompetencat e tij për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit.

8. Subjekti i interesuar, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

8.1 Rektorati pasi është vënë në dijeni për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë me shkresën nr.1574/1 prot., datë 9.9.2014, ka njoftuar përmbartuesin gjyqësor, duke shprehur gatishmëri në ekzekutimin e vendimit, por nuk ka pasur korrespondencë të mëtejshme.

8.2 Spitali Universitar “Koço Gëlozheni”, me shkresën nr. 704 prot., datë 7.11.2016, i është drejtuar rektoratit duke kërkuar sqarim lidhur me institucionin që duhet të emërojë shefat e shërbimeve. Rektorati, me shkresën nr. 2629/1 prot, datë 2.12.2016, ka sqaruar se lidhur me këtë informacion duhet t'i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë si organi që ka nxjerrë aktet.

8.3 Në vendimin nr. 9441, datë 23.9.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk janë sqaruar pasojat juridike që vijnë nga deklarimi i pavlefshëm i aktit juridik, pasi nuk janë kërkuar nga kërkuesi. Në zbatim të vendimit unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë vetëm deklarimi si i pavlefshëm i veprimit juridik, i cili në kuptim të ligjit nuk ka prodhuar pasojat juridike, pa treguar shkakun e këtij veprimi dhe pasojat, nuk mund të merret në shqyrtim nga gjykata.

9. Përmbartuesi gjyqësor privat Xhafer Sadiku nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30/2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

11. Subjekti i interesuar, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, ka pretenduar se vendimi nr. 9441, datë 23.9.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është titull ekzekutiv, pasi vetëm ka konstatuar pavlefshmërinë e tij dhe nuk ka rregulluar pasojat juridike të urdhrimit të ministrit.

12. Gjykata konstaton se në çështjen në shqyrtim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 9441/U, datë 23.9.2013, duke arsyetuar se bazuar në nenin 510/a të KPC-së, vendimi nr. 9441, datë 23.9.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përbën titull ekzekutiv ka vendosur lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit.

13. Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar për vlefshmërinë e titullit ekzekutiv është i lidhur me zbatimin e ligjit në çështjen konkrete. Ky subjekt për pretendimin e tij ka në dispozicion mjete juridike të parashikuara nga ligji, si padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv apo padinë e kundërshtimit të veprimeve të përmbartuesit gjyqësor. Si rrjedhim, Gjykata çmon se pretendimi i subjektit të interesuar nuk hyn në juridiksionin e gjykimit kushtetuese por në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

14. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund



të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 1, datë 21.1.2016, nr. 6, datë 23.2.2016; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuarit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkruesore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Ndërsa për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

i) Kompleksiteti i çështjes

16. Çështja në shqyrtim ka si objekt ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9441, datë 23.9.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë, me të cilin është vendosur konstatimi i pavlefshmërisë së urdhrit nr. 282, datë 30.4.2013 të ministrit të Shëndetësisë. Me këtë urdhër është bërë riorganizimi i strukturave të shërbimeve të QSUT-së, si rrjedhim lirim i kërkuarit nga detyra si shef i Klinikës së Patologjisë së Barrës.

17. Gjykata çmon se nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së kërkuarit dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii) Sjellja e kërkuarit

18. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuarit, të cilat mund të kenë çuar në moszekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

19. Në çështjen konkrete Gjykata vlerëson se kërkuari nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Lidhur me afatet kohore, vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mban datën 23.9.2013 dhe deri në ditën e gjykimit nga kjo Gjykatë autoritetet e caktuara nuk kanë kryer veprimet e nevojshme për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

20. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

iii) Sjellja e autoriteteve

21. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



22. Sipas kërkesës dhe dokumenteve bashkëlidhur rezultojnë se përmbaruesi gjyqësor privat Xhafer Sadiku i ka dërguar në vazhdimësi shkresa Ministrisë së Shëndetësisë, SUOGJ-së “Koço Gëlozheni”, si dhe Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë. Me shkresën nr. 232 prot., datë 29.7.2014 i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit dhe me shkresën nr. 250 prot., datë 2.9.2014 i është drejtuar SUOGJ-së. Me shkresën nr. 268 prot., datë 22.9.2014 i është drejtuar SUOGJ-së dhe Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë duke urdhëruar ekzekutimin e vendimit. Në kushtet kur nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin e vendimit, me shkresën nr. 318 prot., datë 31.10.2014, përmbaruesi gjyqësor ka marrë vendim për dënim me gjobë ndaj SUOGJ-së “Koço Gëlozheni”.

23. Lidhur me vendimin për vendosjen e gjobës, me shkresën nr. 694 prot., datë 4.11.2014 drejtoresha e spitalit universitar “Koço Gëlozheni” ka sqaruar se kërkuar paguhet nga spitali, por emërimi “shef klinike” në patologjinë e hershme nuk është në strukturë. Në shkresë vijon se lidhur me këtë i është kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë ndryshimi i strukturës, pasi nuk është në kompetencë të spitalit. Pas këtyre korrespondencave, përmbaruesi gjyqësor, me vendimin nr.324 prot., datë 7.11.2014, ka vendosur revokimin e gjobës. Me shkresat nr. 330 prot., datë 17.11.2014, nr. 18, datë 12.1.2015, nr. 99 prot., datë 16.3.2015, nr. 58 prot., datë 21.3.2016 dhe nr. 59 prot., datë 21.3.2016 përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë duke kërkuar marrjen e masave për ekzekutim vullnetar të detyrimit. Me shkresën nr. 640 prot., datë 29.1.2014 ministri i Shëndetësisë i është drejtuar drejtorit të SUOGJ-së për marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por pa marrë masa vetë ai si autoritet shtetëror për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Përmbaruesi privat, me shkresën nr. 152 prot., datë 22.5.2015, ka vendosur dënimin me gjobë për Ministrinë e Shëndetësisë. Me shkresën nr. 136 prot., datë 16.7.2016, përmbaruesi gjyqësor i ka dërguar SUOGJ-së informacion për ekzekutimin e vendimit. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përmbaruesi gjyqësor privat ka ndërmarrë hapat proceduralë të nevojshëm për ekzekutimin e vendimit.

24. Në lidhje me sjelljen e autoritetit tjetër, Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, me shkresën 1574/1 prot., datë 9.9.2014 ka parashtruar se do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, por nuk ka kryer efektivisht asnjë veprim. Nga materialet e depozituara midis Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë dhe spitalit “Koço Gëlozheni” ka pasur shkëmbim të disa shkresave për sqarim lidhur me emërimin e shefit të shërbimeve dhe shefave të klinikave, pagesën e tyre dhe të drejtat e detyrat e shefit të shërbimeve, pasi në drejtorinë e spitalit nuk ka pasur asnjëherë njofim zyrtar për emërimin e shefit të shërbimit dhe të shefave të klinikave. Me shkresën nr. 2629/1, datë 2.12.2016, Rektorati i Universitetit të Mjekësisë i është drejtuar drejtorit të SUOGJ-së duke e sqaruar se për çështjen duhet t’i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë si organi kompetent për nxjerrjen e akteve.

25. Në përgjigje të këtyre shkresave dekani i Fakultetit të Mjekësisë ka sqaruar se informacioni i kërkuar nga drejtoresha e spitalit nuk është në kompetencën e Fakultetit të Mjekësisë dhe se duhet t’i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë si organi epror.

26. Gjykata konstaton se duke filluar nga data 23.9.2013, kur është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka pasur një korrespondencë të gjatë midis kërkuar, shoqërisë përmbarimore dhe autoriteteve shtetërore. Gjatë gjithë kësaj kohe nga ana e palës debitorë, konkretisht Ministrisë së Shëndetësisë, si palë e paditur gjatë procesit gjyqësor, nuk është marrë asnjë masë konkrete për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Gjykata çmon se është detyrim i debitorit të gjejë mundësitë e duhura për të ekzekutuar detyrimin sipas vendimit gjyqësor dhe jo të paraqesë pengesa.

27. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen me kërkuar Ilir Tasha ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i, të



Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9441, datë 23.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar) Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 26, datë 27.3.2017

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | |
|-----------------|-----------|----------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i | Gjykatës Kushtetuese |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ “ |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.2.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 95/31 Akti, që i përket:

KËRKUES:Gjergj Marku

SUBJEKT I INTERESUAR:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Drejtoria IEPV Shënkollë Lezhë

OBJEKTI:Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 666, datë 6.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 6, datë 9.1.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2016-13, datë 14.1.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 29, 41, 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 dhe vijues të ligjit nr. 8577,

datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuessit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka kryer detyrën e punonjësit të rolit bazë pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEPV) Shënkollë, Lezhë. Me urdhrin nr. 7651/1, datë 12.10.2009 të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve është vendosur largimi nga detyra i kërkuessit me motivacionin për shkelje të rënda të rregullave të shërbimit. Kjo masë është ankimuar nga kërkuessi në Komisionin e Apelimit të Masave Disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë. Ky i fundit, me vendimin nr. 8531/2, datë 7.12.2009, ka vendosur të propozojë rishikimin e masës disiplinore të dhënë ndaj kërkuessit.

2. Në datën 11.1.2010 Drejtoria e Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ka zhvilluar seancë dëgjimore në prani të kërkuessit për vlerësimin e propozimit të bërë nga Komisioni i Ankimit të Masave Disiplinore. Në përfundim të kësaj procedure është vendosur lënia në fuqi e urdhrin nr. 7651/1, datë 12.10.2009 për largimin nga puna të kërkuessit.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesëpadi me objekt shpalljen të pavlefshëm të urdhrin të lartpërmendur, detyrimin e subjektit të interesuar, IEPV Shënkollë, Lezhë, të paguajë në favor të tij pagën e një viti si dëmshpërblim për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të justifikuara, pagën e 3 muajve si rezultat i mosrespektimit të afatit të njoftimit, pagën e 2 muajve si rezultat i mosrespektimit të procedurës, orët e natës dhe shtesat e shërbimit, si dhe rikthimin në detyrën e mëparshme.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 666, datë 6.7.2010, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e



IEPV-së Shënkollë, Lezhë t'i paguajë kërkuesit shumën prej 544.214 lekësh për shërbimet e kryera në orët e natës, ditët e diela dhe ditët e festave.

5. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 6, datë 9.1.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 666, datë 6.7.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-13, datë 14.1.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji 49/2012”).

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese. Ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

7.1 Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkuesit dhe të drejtën e ankimit, pasi nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij që lidhen me shkeljen e ligjit dhe të drejtave të tij kushtetuese.

7.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbush kërkesat as për një arsyetim minimal.

7.3 Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, pasi kërkuesit i është dhënë një masë jo proporcionale në shkelje të ligjit.

7.4 Gjykimi në Gjykatën e Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012. Ndërsa në Gjykatën e Apelit Shkodër çështja ka qëndruar pa u gjykuar 2 vjet e 5 muaj.

8. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, ka paraqitur parashtrime me shkrim në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

8.1 Kërkuesi është larguar nga puna me motivacionin: “shkelje të rënda të rregullave të shërbimit”. Gjatë proceseve të zhvilluara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nga provat dhe faktet e paraqitura, ka rezultuar se shkelja e kryer nga kërkuesi ka qenë në kundërshtim me ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”.

Faqe | 3714

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatë brenda afatit të parashikuar nga ligji nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se në thelb pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme i referohet faktit se masa e dhënë për shkelje të ligjit ka qenë joproportionale. Një pretendim i tillë ka të bëjë me interpretimin e ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve” dhe, për rrjedhojë, nuk mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues. Gjykata ndërhyr vetëm në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti apo interpretim ligji, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të*



Gjykatës Kushtetuese). Për pasojë, Gjykata çmon se kërkuksi nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këtë pretendim.

B. *Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, të së drejtës së ankimit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

12. Kërkuksi pretendon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit, pasi nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij që lidhen me shkelje të ligjit dhe të të drejtave të tij kushtetuese. Konkretisht, nuk u është dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs lidhur me proporcionalitetin e masës disiplinore; arsyetimet e vendimeve të dy gjykatave të faktit nuk mbështeten nga provat e administruara në gjykim; urdhri është nxjerrë pa asnjë motiv ligjor; raporti ku mbështetet urdhri është i sajuar; shkelja e pretenduar nuk mund të konsiderohet shkelje e rëndë; kërkuksit nuk i është komunikuar zyrtarisht masa disiplinore. Gjithashtu, kërkuksi pretendon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit, sepse vendimi i mospranimit të rekursit nuk përmbush as kërkesat për një arsyetim minimal.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje të arsyetuar përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuksit do të trajtohen në këndvështrim të respektimit të standardit të arsytimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të

mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Ndërsa lidhur me vendimet e mospranimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata është shprehur edhe herë të tjera për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për



kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative në nenin 61 ka përcaktuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, kurse në nenin 62 ka parashikuar se cilat janë, përjashtimisht, rastet e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

17. Në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit jo vetëm përmban pjesën hyrëse, pretendimet e parashtruara nga palët, por edhe arsyetimin e gjykatës, me anë të të cilit ajo u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, duke argumentuar se ndodhemi para shkëlqes së rregullave të shërbimit dhe masa disiplinore është marrë në respektim të procedurës së parashikuar nga ligji për Policinë e Burgjeve. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Po të njëjtit arsyetim i është referuar edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Nga sa më lart, Gjykata çmon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara nga kjo Gjykatë lidhur me detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi.

18. Nga ana tjetër, për sa i përket arsyetimit të kufizuar të vendimeve të dhomës së këshillimit, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja ka pranuar se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës

(*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

19. Për pasojë, Gjykata vlerëson se për sa kohë Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs dhe i ka dhënë përgjigje kërkuarit se pretendimet nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, pretendimi i kërkuarit është i pabazuar.

C. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

20. Kërkuari pretendon se gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit të përcaktuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit prej gjykatës ku ai është depozituar. Gjithashtu, kërkuari pretendon se në Gjykatën e Apelit Shkodër çështja ka qëndruar pa u gjykuar 2 vjet e 5 muaj.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejkzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 1, datë 21.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në konkluzionin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të vlerësohet analiza e secilit prej elementeve të sipërcituara.



i) Periudha që duhet marrë në konsideratë

23. Lidhur me pretendimin për zgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë tej afatit të arsyeshëm, nga materialet e administruara Gjykata vëren se çështja në shqyrtim është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2013 dhe gjykimi është bërë në vitin 2016, ndonëse neni 60/2 i ligjit nr.49/2012 parashikon afatin prej 90 ditësh për shqyrtimin e çështjes nga kjo Gjykatë, pra jashtë afatit ligjor të lartpërmendur.

ii) Kompleksiteti i çështjes

24. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shpresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkuesit

26. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

27. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për

detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjën rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme*”, dhe në nenin 171/a të KPC-së, sipas të cilit “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj*” (*shih vendimin nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka vërejtur se neni 3 i ligjit nr.49/2012 të lartpërmendur ndër parimet e gjykimin administrativ, ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin bashkëlidhur projektligjit nr.49/2012 thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata, gjithashtu, vëren se në relacionin e projektligjit të lartpërmendur lexohet se afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate të mirëpërcaktuara për gjykimin në shkallë të parë (neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore), për gjykimin në apel (neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit), si dhe për gjykimin në Gjykatën e Lartë (neni 60/2 në shqyrtim) (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Nga sa më lart, Gjykata është shprehur se përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim



për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Po në këtë këndvështrim Gjykata në çështje të ngjashme ka vlerësuar se justifikimet se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk janë të bazuara. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Lidhur me procesin në Gjykatën e Apelit Shkodër Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuarit për tejzgjatje të procesit është i paargumentuar në të gjitha elementet e tij si më lart, dhe si i tillë nuk është i bazuar.

31. Në këto kushte, Gjykata arrin në përfundimin se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë i parregullt, për shkak se çështja në këtë Gjykatë nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshem, siç parashikohet dhe në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012. Për pasojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshem, të parashikuar nga neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012, është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 73/4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshem.

- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Pjesërisht kundër¹: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 27, datë 27.3.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | |
|-----------------|-----------|----------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i | Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 31.1.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 85/21 Akti që i përket:

KËRKUES: Aldo Bare

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2015-2087, datë 2.7.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 49, datë 16.7.2012 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; nr. 24, datë 25.1.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 54, datë 3.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda; nr.17, datë 28.3.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 31, 32, 42, 131/f, 134/1/i dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 4 i protokollit 7 të kësaj konvente; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

¹ Gjyqtarja V. Tusha ka votuar kundër konstatimit të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshem.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Aldo Bare, që kërkoji pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoji rrezimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuar Aldo Bare (Alfred Shkurti) është marrë si i pandehur dhe është dërguar për gjykim për një sërë veprash penale të parashikuara nga nenet 78, 151, 333 dhe 334 të Kodit Penal (KP).

2. Me vendimin nr. 17, datë 28.3.2011 Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese kundër dy ose më shumë personave” në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh”, 25 dhe 22 të KP-së, kundër shtetasit G.K. e A.D. dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 23 (njëzetë e tre) vjet burgim; deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78/2 i KP-së, si dhe në aplikim të nenit 3/3 të KP-së të shtetasit X.H.D. si veprë penale të kryer në kuadër të Organizatës Kriminale, të parashikuar nga neni 334, paragrafi i dytë i KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me burgim të përjeshëm; deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78/2 i KP-së, si dhe në aplikim të nenit 3/3 të KP-së, të shtetasit N.Z. si veprë penale të kryer në kuadër të Organizatës Kriminale, të parashikuar nga neni 334, paragrafi i dytë i KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 25 (njëzetë e pesë) vjet burgim; deklarimin fajtor të të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim” mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78/2-22 të KP-së, si dhe në aplikim të nenit 3/3 të KP-së, të shtetasit M.A. si veprë penale të kryer në kuadër të Organizatës Kriminale, të parashikuar nga neni 334, paragrafi i dytë i KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 25 (njëzetë e pesë) vjet burgim; deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti), për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78/2 i KP-së, si dhe në aplikim të nenit 3/3 të KP-së, të shtetasit M.A. si veprë penale të kryer në kuadër të Organizatës Kriminale, të parashikuar nga neni 334, paragrafi i dytë i KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 25 (njëzetë e pesë) vjet burgim; deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti), për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 5 (pesë) vjet burgim; deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti), për kryerjen e veprës penale të “Shkatërrimit të pronës me zjarr”, e parashikuar nga neni 151/2 i KP-së, si dhe në aplikim të nenit 3/3 të KP-së, si veprë penale e kryer në kuadër të Organizatës Kriminale, të parashikuar nga neni 334, paragrafi i dytë i KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim; deklarimin fajtor të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti) për kryerjen e veprës penale të “Krijimit të organizatës kriminale”, parashikuar nga neni 333 i KP-së, në aplikim të nenit 3/3 të KP-së, dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 8 (tetë) vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të KP-së “Caktimi i dënimeve për disa vepra penale” gjykata në përfundim i jep dënimit e vetëm burgim të përjeshëm të pandehurit Aldo Bare (i quajtur ndryshe Alfred Shkurti)”.

3. Mbi ankimin e mbrojtjes, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 54, datë 3.10.2011, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 17, datë 28.3.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”.

4. Mbi rekursin e prokurorit dhe të mbrojtjes, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-415 (24), datë 25.1.2012, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 54, datë 3.10.2011 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues.”.

5. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 49, datë 16.7.2012, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 17, datë 28.3.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.”.



6. Mbi rekursin e prokurorit dhe të mbrojtjes, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2087, datë 2.7.2015, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të rekursit të paraqitur nga i gjykuari Aldo Bare (Alfred Shkurti) kundër vendimit nr. 49, datë 16.7.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.”*

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt shqyrtimi me pretendimin se këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimitet e mëposhtme:

7.1 *Gjykatat kanë cenuar nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtën e mbrojtjes*, pasi në rastin konkret ai nuk është njoftuar në mënyrën e duhur për akuzën dhe aktet e dosjes hetimore në ngarkim të tij. Në vendimin e datës 11.6.2007 të prokurorëve për marrjen të pandehur të kërkuesit ndodhet shënimi se ky vendim i është njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Po ky vendim, në kundërshtim me nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), nuk i është komunikuar dhe njoftuar kërkuesit. Gjithashtu, edhe prokuroria nuk ia ka bërë me dije gjykatës se po shtonte një akuzë të re. Në seancën e datës 3.2.2010 gjykata e shkallës së parë ka vendosur të vazhdojë gjykimin pa praninë e kërkuesit, megjithëse ishte kërkuar prej tij pjesëmarrja në këtë fazë të gjyimit.

7.2 *Gjykatat kanë cenuar të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja penale në ngarkim të Aldo Bares (Alfred Shkurti) etj. është regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë në datën 7.2.2006 me nr. 15 procedimi. Në total afati i hetimeve për Aldo Baren (Alfred Shkurti) ka kaluar afatin maksimal të hetimeve, i cili është dy vjet.

7.3 *Gjykatat nuk kanë pranuar kërkesën për t'u proceduar me gjykim të shkurtuar*. Kjo kërkesë u refuzua nga ana e gjykatës, megjithëse siç rezultoi më vonë gjatë zhvillimit të procesit gjykata i pranoi të gjitha aktet e përpiluara gjatë hetimeve paraprake nga ana e organit të akuzës pa rrëzuar asnjë prej tyre. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar nuk kishte asnjë arsye ligjore për t'u refuzuar, pasi çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, pra duke u mbështetur tek aktet e përpiluara gjatë hetimeve paraprake.

7.4 *Gjykatat kanë cenuar parimin e gjyimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi çështja në ngarkim të Aldo Bares (Alfred Shkurtit) është gjykuar me gjyqtarë të deleguar me vendim të KLD-së nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pavarësisht se këta gjyqtarë ishin të deleguar, përsëri në caktimin e tyre KLD-ja duhej t'u përmbahej parimeve të përgjithshme për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Kryesuesja e trupit gjykues nuk i përket Kolegjit Penal por atij Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, prandaj ajo nuk mund të gjykojë një çështje penale.

7.5 *Gjykatat kanë cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi Gjykata për Krime të Rënda u është referuar disa vendimeve të tjera penale që janë dhënë për disa të pandehur të tjerë, ku pretendohet se ka ekzistuar një organizatë kriminale e drejtuar nga kërkuesi, dhe bazuar në këto vendime ajo e ka deklaruar kërkuesin fajtor edhe për këtë vepër. I gjithë procedimi penal kundër të ashtuquajturës “Banda e Lushnjës” ka qenë objekt i sulmeve, fjalimeve dhe deklaratave politike nga ana e funksionarëve të lartë të shtetit duke krijuar një perceptim krejtësisht të gabuar si të gjykata, ashtu dhe tek opinionin publik.

7.6 *Gjykatat kanë cenuar nenin 32/2 të Kushtetutës, sepse e kanë dënuar kërkuesin në bazë të provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*. Shtetasi G.S. paraqitet në seancën e datës 7.4.2010, në të cilën pyetet si i pandehur në një procedim të lidhur. Me gjithë kundërshtimin e mbrojtjes për të qartësuar statusin e tij, pasi ai u paraqit i lirë në sallën e gjyqit, gjykata vazhdoi me pyetjen e tij me cilësinë e të pandehurit në një procedim të lidhur. Gjykata duhej të saktësonte nëse ky shtetas ishte i pandehur dhe i lidhur me akuzat e Aldo Bares apo ishte dëshmitar, si dhe duhej të kishte pasur parasysh kërkesat e nenit 156/1/b të KPP-së.

7.6.1 Përveç sa më sipër, kërkuesi pretendon cenimin e nenit 32 të Kushtetutës në disa aspekte të cilat sqarohen në vijim:

7.6.1.1 *Mosrespektimi i nenit 24/5 të KPP-së*. Me vendim të ish drejtorit të Drejtorisë kundër Krimit të Organizuar, Z.SH., në mënyrë haptazi të kundërligjshme janë shfuqizuar disa vendime pushimi, në kundërshtim me nenin 24/5 të KPP-së.

7.6.1.2 *Mosrespektimi i nenit 128 të KPP-së dhe deklarimi i kërkuesit fajtor bazuar në akte absolutisht të pavlefshme*. Gjatë marrjes në pyetje të shtetasve L.D.,



S.D. dhe A.D. nuk është paraqitur asnjë mjet dhe asnjë dokument identifikimi që të vërtetojë identitetin e tyre.

7.7 Gjykatat kanë cenuar parimin e mosdënimit pa ligj, parashikuar në nenin 29 të Kushtetutës, pasi për sa i takon akuzës së “shkatërrimit të pronës me zjarr” të shtetasit SH.H., ajo është parashkruar. Banesa është djegur në datën 22 gusht 1998 dhe procedimi penal për këtë veprë ka nisur në vitin 1998, i cili më pas është pezulluar. Në vitin 2005 për këtë çështje kanë rifilluar hetimet. Neni 66 i KP-së parashikon se nuk mund të bëhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar dhjetë vjet, për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim. Kjo veprë në kohën që është kryer është kualifikuar sipas nenit 151/1 të KP-së, i cili parashikonte dënimin deri në 5 vjet dhe ndjekja penale për këtë veprë është parashkruar. Gjithashtu, duke krahasuar dispozitat e parashikuara të KP-së lidhur me veprën penale të organizatës kriminale, rezulton se neni 333 i Kodit në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale parashikonte se krijimi i bandës së armatosur apo organizatës kriminale ose pjesëmarrja në to, me qëllim kryerjen e krimeve, dënohej nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet, kurse me ndryshimet që iu bënë Kodit në vitin 2004, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal u parashikuan si vepra penale më vete dhe, në bazë të nenit 333 të KP-së, krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, kurse pjesëmarrja në një organizatë kriminale dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

7.8 Gjykatat kanë cenuar parimin *ne bis in idem*, pasi në rastin e gjykimit të kërkuesit Aldo Bare (Alfred Shkurti), ai është akuzuar sërish për një veprë për të cilën një vendim i mëparshëm e ka shpallur të pafajshëm. Kërkuesi i gjykuar njëherë dhe i deklaruar i pafajshëm me vendim penal të formës së prerë për veprën penale të pjesëmarrjes në bandën e armatosur, tashmë gjykohet për të njëjtën veprë, por nën titullin e krijimit të organizatës kriminale, një veprë penale që parashikohet nga e njëjta dispozite, neni 333 i KP-së.

7.9 Gjykatat kanë cenuar të drejtën për një vendim të arsyetuar, pasi vendimi nr. 17, datë 28.4.2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është absolutisht i pavlefshëm sepse i mungon

dispozitivi. Konkretisht, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është shprehur për njërën prej akuzave në ngarkim të kërkuesit, pikërisht për akuzën e vrasjes me paramendim të shtetasit L.B.

7.10 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit, pasi në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë janë paraqitur pretendime, që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes. Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura nga kërkuesi, ka cenuar të drejtën e aksesit.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë element të cenimit të të drejtave kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes është i pabazuar, pasi për vrasjen e shtetasit L.B. prokuroria nuk rezultoi të ketë ngritur akuzë ndaj kërkuesit. Edhe në konkluzionet përfundimtare të prokurorisë nga prokurori i seancës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, kjo veprë u është atribuar shtetasve I.S. dhe A.B. Për sa i përket pretendimit për vazhdimin e gjykimit në mungesë të kërkuesit në seancën e datës 3.2.2010, vlen të theksohet fakti se mungesa e kërkuesit në seancë ka qenë plotësisht e vullnetshme dhe se nuk rezultoi të ketë pasur ndonjë pengesë objektive që e ka penguar atë të marrë pjesë në seancë.

8.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është i pabazuar, pasi këtë pretendim kërkuesi e lidh vetëm me fazën e hetimeve paraprake dhe nuk e ka shtrirë edhe për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor. Nga vendimet gjyqësore rezultoi se ky pretendim i kërkuesit i është nënshtruar shqyrtimit të gjykatave dhe ka marrë përgjigje të arsyetuar në vendimet gjyqësore.

8.3 I pabazuar është edhe pretendimi për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, pasi interpretimi i ligjit material dhe atij procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Pretendimi i kërkuesit për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar hyn në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe nuk mund të ngrihet në nivel kushtetues.



8.4. *Edhe pretendimi për cenimin e parimit të gjyqimit nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar*, pasi neni 15 i ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikës e Shqipërisë” (në fuqi në momentin e regjistrimit të çështjes penale në gjykatë) parashikonte se ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhej me short, sipas procedurave të caktuara me ligj. Në këtë kuptim, procedurat e shortit, të cilave u referohet kjo dispozitë ligjore, janë të zbatueshme për ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe ato nuk i referohen procedurës që zhvillohet nga KLD-ja për delegimin e gjyqtarëve. Në caktimin e kryesuesit të trupit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka zhvilluar procedurën e hedhjes së shortit.

8.5 *Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar*, pasi nuk rezulton se në vendimet gjyqësore të ketë ndonjë të dhënë, e cila të tregojë se gjykatat e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe në to nuk përmendet ndonjë deklaram formale ose arsytim, i cili të tregojë se gjykatat e kanë konsideruar fajtor kërkuesin para se të jepej vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. Nuk rezulton, gjithashtu, që gjykata të ketë kaluar barrën e provës nga prokurori tek i gjykuari apo të mos kenë vlerësuar dyshimet në favor të tij.

8.6 *Pretendimi i kërkuesit se është dënuar në bazë të provave të mblledhura në mënyrë të paligjshme nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues*, pasi vlerësimi juridik i rrethanave, provave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit, përfshirë edhe kualifikimin e veprave penale, janë në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për sa i përket të pandehurit G.S. gjykatat kanë analizuar pozitën procedurale të tij në procesin penal. Për sa i përket pretendimit për zotësinë juridike të shtetasve A.D., L.D. dhe S.D. për shkak të mosverifikimit të identitetit të tyre në momentin e marrjes së deklaramëve, ky pretendim nuk qëndron.

8.7 *Pretendimi i kërkuesit se është cenuar ndalimi kushtetues i mosdënimit pa ligj është i pabazuar për këto arsye*: vepra penale e “shkatërrimit të pronës me zjarr”, e parashikuar nga neni 151/2 i KP-së nuk është parashikuar. Akuzat për këtë veprë i është komunikuar kërkuesit dhe pretendimi i kërkuesit se kjo veprë është kualifikuar sipas nenit 151/1 të KP-së nuk qëndron. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në vendimin e saj nr. 17, datë

28.3.2011, këtë veprë penale e ka kualifikuar sipas nenit 151/2 të KP-së. Neni 151/2 i KP-së parashikon se “kur nga vepra penale janë shkaktuar pasojat të rënda materiale, dënohet me burgim gjer në 10 vjet”. Në këto kushte neni 151/2 i KP-së parashikon një dënim gjer në dhjetë vjet burgim. Sipas nenit 66 të KP-së afati i parashkrimit për këtë veprë është 10 vjet.

8.8. *Pretendimi i kërkuesit se është cenuar parimi ne bis in idem nuk është i bazuar*, pasi në çështjen në shqyrtim kërkuesi është gjetur fajtor, ndër të tjera, për veprën penale të pjesëmarrjes në organizatë kriminale dhe jo në bandë të armatosur, sipas parashikimeve të nenit 333 të KP-së. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.289, datë 21.12.2001, ka vendosur pushimin e gjyqimit për kërkuesin për akuzën e “Krijimit dhe pjesëmarrjes në bandë të armatosur”, parashikuar nga neni 333 i KP-së, pasi nuk provohet fajësia. Në kohën kur është gjykuar kërkuesi për pjesëmarrje në bandë të armatosur, KP-ja bënte dallim ndërmjet pjesëmarrjes në bandë të armatosur dhe në organizatë kriminale.

8.9 *Vendimet e gjykatave e kanë respektuar parimin e arsytimit*, pasi ato i kanë përmbushur standardet e përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me parimin e arsytimit. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për një akuzë të re të ngritur nga prokuroria në fund të procesit, si dhe të mosshprehjes së gjykatës në dispozitivin e vendimit, ky pretendim nuk qëndron dhe për këtë është shprehur edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në vendimin e saj.

8.10 *Pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nuk qëndron*, pasi Kolegji Penal që ka vendosur mospranimin e rekursit ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Në jurisprudencë konstante, në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë në pajtim me kërkesat ligjore mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

9. Gjykata vëren se kërkueti legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkueti *prima facie* legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

11. Kërkueti pretendon se në rekursin e paraqitur në Gjykatë të Lartë ka paraqitur pretendime, që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes. Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura nga kërkueti, ka cenuar të drejtën e aksesit.

12. Gjykata ka pranuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të çdo individit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vështrim, Gjykata mund të vlerësojë mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takon gjykatave të sistemit të zakonshëm, vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste Gjykata analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, gjë që përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e kësaj Gjykate nuk është zgjidhja e një çështjeje konkrete, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t’u japë përgjigje problemeve ligjore, që në praktikë lidhen

me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës, në të tilla raste kërkueti duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës përbën një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë e individit është garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t’iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë edhe ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr.84, datë 30.12.2016; nr.67, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë



formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes së të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 21, datë 24.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkuarit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Po ashtu, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës

së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime, që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuari në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka ngritur pretendime të natyrës kushtetuese. Konkretisht, ai ka ngritur pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, për shkak se nuk është njoftuar në mënyrën e duhur për akuzën dhe aktet e dosjes hetimore në ngarkim të tij. Sipas tij, në vendimin e datës 11.6.2007 të prokurorëve për marrjen si të pandehur ndodhet shënimi se ky vendim i është njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Por ky vendim, në kundërshtim me nenin 34 të KPP-së nuk i është komunikuar dhe njoftuar kërkuarit. Në rekurs kërkuari ka pretenduar se gjykatat kanë cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, pasi gjyqtarët të cilët kanë gjykuar çështjen nuk janë zgjedhur me short. Më tej, kërkuari ka pretenduar se kryesuesja e trupit gjyqësor nuk i përket Kolegjit Penal por atij Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, prandaj ajo nuk mund të gjykonte një çështje penale. Por megjithëse nga ana e mbrojtjes u kërkuar përjashtimi i saj, kërkesa nuk u pranua. Gjithashtu, kërkuari ka parashtruar përpara Gjykatës së Lartë se gjykatat kanë cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Ai ka pretenduar se i gjithë procedimi penal kundër të ashtuquajturës “Banda e Lushnjës” ka qenë objekt i sulmeve, fjalimeve dhe deklaratave politike nga ana e funksionarëve të lartë të shtetit duke krijuar një perceptim krejtësisht të gabuar si të gjykata, ashtu dhe tek opinionin publik. Një tjetër pretendim i kërkuarit ka qenë ai se gjykatat kanë cenuar nenin 32/2 të Kushtetutës sepse e kanë dënuar në bazë të provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Sipas tij shtetasi G.S. është paraqitur në seancën e datës 7.4.2010 në të cilën është pyetur si i pandehur



në një procedim të lidhur. Statusi i këtij personi kishte rëndësi shumë të madhe, pasi mosaktimi i drejtë i pozitës së tij ka çuar në shkelje procedurale në marrjen e provës. Më tej kërkuesi ka pretenduar se me vendim të ish-drejtorit të Drejtorisë kundër Krimet të Organizuar, Z.SH., në mënyrë haptazi të kundërligjshme janë shfuqizuar disa vendime pushimi, në kundërshtim me nenin 24/5 të KPP-së. Kërkuesi ka pretenduar në rekurs se gjykatat kanë cenuar parimin e mosdënimit pa ligj e sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës. Ai ka argumentuar se për sa i takon akuzës së “shkatërrimit të pronës me zjarr” të shtetasit SH.H., ajo është parashkruar. Banesa është djegur në datën 22 gusht 1998 dhe procedimi penal për këtë veprë ka nisur në vitin 1998, i cili më pas është pezulluar. Hetimet për këtë çështje kanë rifilluar në vitin 2005. Sipas kërkuesit neni 66 i KP-së parashikon se nuk mund të bëhet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si i pandehur kanë kaluar dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim. Kjo veprë në kohën që është kryer është kualifikuar sipas nenit 151/1 të KP-së, i cili parashikonte dënimin deri në 5 vjet dhe ndjekja penale për këtë veprë është parashkruar. Një pretendim tjetër i kërkuesit në Gjykatën e Lartë ka qenë cenimi i parimit *ne bis in idem*, sepse ai është akuzuar sërish për një veprë për të cilën një vendim i mëparshëm e ka shpallur të pafajshëm. Ai ka pretenduar se është gjykuar njëherë dhe është deklaruar i pafajshëm me vendim penal të formës së prerë për veprën penale të pjesëmarrjes në bandën e armatosur, dhe është gjykuar prapë për të njëjtën veprë, por nën titullin e krijimit të organizatës kriminale, një veprë penale që parashikohet nga e njëjta dispozite, neni 333 i KP-së. Ai ka pretenduar gjithashtu se gjykatat kanë cenuar të drejtën për një vendim të arsyetuar. Sipas tij vendimi nr. 17, datë 28.4.2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është absolutisht i pavlefshëm, pasi atij i mungon dispozitivi. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është shprehur për njërin prej akuzave në ngarkim të kërkuesit, pikërisht për akuzën e vrasjes me paramendim të shtetasit L.B.

20. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi ka paraqitur pretendime të natyrës kushtetuese. Në këtë rast, Gjykata e Lartë këtyre pretendimeve duhej t’ju jepte përgjigje dhe nuk

duhej të vendoste mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit

21. Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej për to në respektim të rolit të saj kontrollues si gjykatë ligji dhe parimit të subsidiaritetit.

22. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen e kërkuesit Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, pasi është mohuar akses në kuptimin substancial duke mos marrë përgjigje për pretendimet e ngritura prej tij, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit.

C. Për pretendimet e tjera

23. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me kërkesën për gjykim të shkurtuar, mbledhjen e provave në mënyrë të paligjshme, cenimin e së drejtës së mbrojtjes, të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, parimin e mosdënimit pa ligj, parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e gjykimit dy herë për një veprë penale (*ne bis in idem*), si dhe parimin e arsytimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t’u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të mësipërme të ngritura në rekurs.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuës me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-2087, datë 2.7.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.



Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj
Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Shumica ka vendosur pranimin e kërkesës së shtetasit Aldo Bare dhe ka shfuqizuar si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vendimin nr. 00-2015-2087, datë 2.7.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi). Nuk pajtohem me vendimin e shumicës për arsyet si më poshtë.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi, pasi është dënuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe ka shteruar mjetet, i është drejtuar kësaj Gjykate duke pretenduar *cenimin e së drejtës së mbrojtjes*, për shkak se nuk është njoftuar në mënyrën e duhur për akuzën dhe aktet e dosjes hetimore në ngarkim të tij; *cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës; *cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj*, të përcaktuar në nenin 29 të Kushtetutës; *cenimin e parimit ne bis in idem, cenimin e së drejtës për të pasur një vendim të arsyetuar, cenimin e së drejtës së aksesit*.

3. Shumica ka ritheksuar qëndrimin e jurisprudencës të kësaj Gjykate, sipas së cilës, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime, që kanë të bëjnë me shkëlqen e

parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde shumica ka arritur në përfundimin se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej për to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit (*shih paragrafët nr. 18 dhe nr. 21 të vendimit të shumicës*).

4. Në jurisprudencën e Gjykatës, kërkesat e individëve, sipas të cilave, Gjykata e Lartë me vendimin e mosprimit në dhomë këshillimi nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs, në varësi të natyrës së çështjes, janë trajtuar në dy mënyra:

- së pari, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, në disa raste është vendosur shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në atë Gjykatë (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*);

- së dyti, në respekt të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për ta bërë vendimmarrjen e kësaj Gjykate efektive, kjo e fundit është shprehur për themelin e pretendimeve, duke rrëzuar kërkesën në rastin kur ato rezultojnë haptazi të pabazuara (*shih vendimin nr. 34, datë 13.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe duke e pranuar kërkesën nëse i ka vlerësuar ato të bazuara (*shih vendimin nr. 46, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Qëndrimet e mësipërme nuk lidhen me ndryshimin apo devijimin nga jurisprudenca e Gjykatës, por me veçoritë që paraqet çdo çështje e veçantë e lidhur kjo dhe me efektivitetin e vendimmarrjes të kësaj Gjykate. Mendojmë se në rastin konkret kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë nuk përbën një mjet juridik efektiv për zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

6. Gjykata, edhe në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me interpretimin e nenit 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, i cili sanksionon termin “ankim efektiv”, ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjetesh, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive.



Në këtë drejtim është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 9, datë 15.3.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. GJEDNJ-ja e ka trajtuar çështjen e efektivitetit të mjetit të ankimit në një perspektivë më të gjerë, duke dhënë disa orientime lidhur me karakteristikat që duhet të ketë një mjet i brendshëm ankimi. GJEDNJ-ja ka konstatuar se mjeti më i mirë i ankimit, si në çdo fushë tjetër, është pa dyshim parandalimi. Ajo ka mbajtur në mënyrë të përsëritur qëndrimin se neni 6/1 imponon mbi shtetet kontraktuese detyrimin për t'i organizuar sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatat të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e tij, veçanërisht për sa i përket afatit të arsyeshëm (*shih, ndër të tjera, Süßmann kundër Gjermanisë nr. 20024/92 prg. 55*). Kur sistemi gjyqësor ka mangësi në këtë drejtim, një mjet i projektuar për të përshpejtuar procedurat, me qëllim parandalimin e kohëzgjatjes së tepërt të procesit, përbën zgjidhjen më efektive. GJEDNJ-ja në shumë raste i ka njohur këtij lloji ankimi një karakter efektiv në masën që ai lejon përshpejtimin e vendimit gjyqësor në fjalë (*shih ndër të tjera Lali kundër Shqipërisë, nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, Scordino kundër Italisë nr. 36813/97 prg. 184, Bacchini kundër Zvicrës nr. 62915/00, Tomé Mota kundër Portugalisë nr. 32082/96*).

8. Në rastin në shqyrtim, nga materialet e çështjes rezulton se procesi hetimor dhe gjyqësor ndaj kërkuesit, si pretendon dhe ai vetë, është tejzgjatur. Çështja në ngarkim të tij është regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë në datën 7.2.2006 dhe ka përfunduar me shqyrtimin në Gjykatën e Lartë në datën 2.7.2015. Kjo është arsyeja që, sipas pikëpamjes tonë, shumica, për t'u mos u bërë palë me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në zvarritjen e mëtejshme të çështjes, duhet t'i hynte shqyrtimit në themel të pretendimeve të kërkuesit, si mjeti dhe mënyra e vetme efektive për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Shumica nuk mund të mos merrte në konsideratë edhe faktin se shkeljet e pretenduara nga kërkuesi janë të natyrës së tillë që *prima facie* nuk justifikojnë kthimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

9. Përveç sa më lart, vlerësojmë se një rishqyrtim i çështjes nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në linjën e kërkuar nga shumica, nuk i shërben efektivitetit të gjykimit kushtetues, pasi në eventualitetin e një përgjigjeje negative nga ana e këtij të fundit, vendimi i shumicës nuk do të përmbushte pritshmëritë e kërkuesit, i cili, në këto rrethana, mund t'i drejtohet përsëri kësaj Gjykate, duke shtyrë më tej në kohë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

10. Përfundimisht vlerësojmë se vendimi i shumicës nuk është në funksion të parimit të drejtësisë efektive, pasi jo vetëm që zvarrit një proces të gjatë gjyqësor, por e kthen vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese nga një mjet efektiv, në një akt formal.

Anëtarë: Vitore Tusha, Vladimir Kristo

| | |
|--|-----------------|
| | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë